



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:116936

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05734918

KPPP.nr.1477/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbaremore të kreditorit “Izoline – KS” SH.P.K., me adresë në Rruga e Barikadave p.n. në Prizren, me numër unik identifikues 810975865, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Valdet Hoxha, avokat nga Prizreni, kundër debitorit “Melodia Projekt” SH.P.K. me adresë në Davidovc rr. “Ibrahim Rugova” në Shtime me numër unik identifikues 811023936, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr.248/2022 të datës 06.05.2022, të Përmbareuesit Privat Rushit Hoxha, me seli të zyrës në Prizren dhe kwrkeshwn pwr kthim nw gjendjen e mwparshme, jashtë seancës me datës 24.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e paraqitur nga debitori “Melodia Projekt” SH.P.K, për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit ndaj Urdhrit Përmbaremore P.nr.248/2022 të datës 06.05.2022, të lejuar nga Përmbareuesi Privat Rushit Hoxha.
- II. HEDHET POSHTË prapësimi i debitorit “Melodia Projekt” SH.P.K, i ushtruar ndaj Urdhrit Përmbaremore P.nr.248/2022 të datës 06.05.2022, të lejuar nga Përmbareuesi Privat Rushit Hoxha, si I PASAFATSHËM.
- III. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim t’ia paguaj kreditorit shumën prej 104.00 € (njëqind e katër euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Izoline – KS” SH.P.K. ka lëshuar Urdhri Përmbaresimor P.nr.248/2022 të datës 06.05.2022, me të cilin e ka lejuar përmbaresimin në bazë të dokumentit të besueshëm, Faturës Nr.1-166 të datës 28.04.2021 me vlerë prej 4,262.60€, me të cilin ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 4,262.60€ si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbaresimore.

Kundër urdhrimit për lejimin e përmbaresimit, debitori ka paraqitur kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme për shkak të humbjes së afatit ligjor për ushtrimin e prapësimit bashkë me prapësim. Përmes kërkesës debitori ka kërkuar kthim në gjendjen e mëparshme për faktin se nga fletë kthesa e urdhrimit nuk arrihet të vërtetohet se kush ka qenë pranues i shkresës dhe se e njëjta nuk është pranuar nga përfaqësues të kompanisë. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që t’ia mundësoj debitorit të kryej veprimin procedural – paraqitjen e prapësimit të cilat pa fajin e tij ka humbur.

Përmes prapësimit ka kërkuar që prapësimi i debitorit të aprovohet në tërësi si i bazuar dhe Urdhri Përmbaresimor P.nr.248/2022 i datës 06.05.2022 të shfuqizohet.

Kreditori përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur përgjigjen në prapësim, përmes së cilës ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pabazuar me arsyetimin se i njëjti nuk ka bazë ligjore, respektivisht nuk janë plotësuar asnjëri nga kushtet e prapësimit. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se kërkesa e debitorit për kthimin në gjendje të mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit është e pabazuar për shkaqet si në vijim:

Me nenin 121 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se *“Vërtetimin mbi dorëzimin e bërë të shkresës (dëftesën e komunikimit) e nënshkruajnë marrësi dhe dorëzuesi. Marrësi do ta shkruajë vetë me shkronja në dëftesën e komunikimit datën e marrjes së shkresës.”*.

Ndërsa, sipas 129.1 të LPK, parashihet se: *“në qoftë se pala nuk shkon në seancë fare apo e humb afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humb të drejtën që më vonë të kryej veprimin procedural të lidhur me afat, gjykata do t’i lejojë kësaj pale, me*

*propozimin e saj të kryej me vonë këtë veprim, po që se konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen”.*

Në këtë drejtim, Gjykata gjeti se Përmbartuesi Privat, ka zhvilluar komunikimin e shkresave me debitorin konform dispozitës së nenit 121 të LPK-së, duke i dërguar debitorit Urdhrit Përmbartimor përmes postës, e cila me datë 12.05.2022 është pranuar nga debitori në adresën adresë në Davidovc rr. “Ibrahim Rugova” në Shtime, adresë kjo e cila është shënuar edhe në kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme dhe prapësimin e paraqitur nga vet debitori.

Rrjedhimisht, dorëzimi i Urdhrit Përmbartimor tek debitori është konsideruar se është dorëzuar me rregull në adresën Davidovc rr. “Ibrahim Rugova” në Shtime, si dhe e njëjta është pranuar nga debitori me datë 12.05.2022, pas të cilës datë, debitori në kuptim të nenit 70 të LPP-së ka pasur afat shtatë (7) ditë për të ushtruar mjetin juridik të prapësimin, pra jo më vonë se 19.05.2024, por që mjetin juridik të prapësimin e ka parashtruar me datë 30.05.2022.

Në anën tjetër, debitori, përkundër që ka paraqitur kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme për shkak të lëshimit të afatit për paraqitjen e prapësimin, i njëjti nuk e ka bërë të besueshëm ekzistimin e ndonjë shkakut të arsyeshëm siç kërkohet me nenin 129 të LPK-së, si rezultat i të cilit i është pamundësuar të njëjtit paraqitja e mjetit juridik të prapësimin.

Andaj, duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret prapësimin i debitorit është paraqitur me datë 30.05.2022, pra pas kalimit të afatit shtatë (7) ditë nga neni 70 i LPP-së, ndërsa debitori nuk ka provuar bazën e kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme, gjykata vendosi si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij Aktvendimi, duke refuzuar kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme dhe duke hedhur prapësimin e debitorit si të pasafatshëm.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbartimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke i’u njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim dhe atë në shumën prej 104.00 € (njëqind e katër euro), siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifën e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 73 par. 3 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1477/23, datë 24.05.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.